

## **Të nderuar pjesëmarrës,**

Në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”, 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (10 qershor 1878) dhe 110 vjetorit të Kongresit të Manastirit, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Banka e Shqipërisë organizojnë Ekspozitën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare”.

Ekspozita është pjesë e agjendës shtetërore e organizuar nga Komisioni Qeveritar për Vitin Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Bashkëpunimi në mes të dy institucioneve tona, gjithmonë ka qenë i shkëlqyer dhe në mënyrë që të përcjellim mesazhin e krenimit të kësaj ngjarje historike, këtë vit bashkërisht kemi vendosur që t’i bashkëngjitemi shënimit të manifestimit “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, i cili përkon me 550 vjetorin e vdekjes së tij dhe 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit .

Me këtë rast BQK-ja në koordinim me Muzeun e Kosovës, Bankën e Shqipërisë dhe Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si nikoqir në këtë ambient të bukur po bënë hapjen e Ekspozitën së Titulluar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare”, ku janë ekspozuar monedha dhe kartëmonedha shqiptare, një pjesë e të cilave janë përdorur edhe në Kosovë gjatë viteve nga Lufta II Botërore).

Ekspozita përmban thesar numizmatik nga të dy shtetet Kosova dhe Shqipëria, kryesisht monedha të përdorura në trojet shqiptare gjatë etapave të ndryshme duke filluar nga shekulli I para Krishtit e deri në ditët e sotme.

Gjithashtu janë të ekspozuara edhe monedhat që nga kohërat antike të periudhës pararomake (V-I para Krishtit), periudhës romake (I-IV pas Krishtit) dhe të periudhës mesjetare (V-XII).

Krejt kjo tregon se në trevat tona që nga lashtësia ka qenë i zhvilluar dhe funksional sistemi financiar për të cilin si dëshmi janë monedhat e përdorura dhe prerjet e tyre gjatë periudhave të ndryshme kohore.

Përveç thesarit numizmatik do të prezantohen edhe tekste historike, imazhe historike, dhe produkte të edukimit financiar të të dyja bankave qendrore, duke prezantuar kështu një shkrirje mes numizmatikës, historisë dhe edukimit.

Ekspozita është e hapur nga sot deri më 12 qershor 2018 dhe ftojmë qytetarët që të vizitojnë këtë  
Ekspozitë të shkëlqyeshme, që është organizuar për herë të parë në një përvjetor të tillë.